

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përdhunoj gruan britanike në një rrugë të Londrës dhe më pas e kërkoi në spital, dënohet me 21 vite burg algjeriani
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/perdhunoi-gruan-britanike-ne-nje-rruge-te-londres-dhe-me-pas-e-kerkoi-ne-sp-i587072
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:18:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 13:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5209c6c6ac8f48c823571ea07f75dd05f3394dc152bfe4ae4dc5daf55783cdeb
TEKSTI	247c1a5a3e291681266dba325532d27f2775314f3434eb35f144b89e1c5cefc7
PAMJA	11ee0667be32ab8fbaf42187037552d8f915aebd2157edc910eb6acfec8c03d4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c65fe3f8bdb6a69fbea7aa22636167731e66a15bdf0ac7d71d00109999c7f320
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c65fe3f8bdb6a69fbea7aa22636167731e66a15bdf0ac7d71d00109999c7f320>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le [AtD e hapur per takim me pertaqesuesit e MoskesU ia jashte listes se Kombetares, "shperthen" sulmuesi: Po rri urte, me mire te mos flas me... Programi "Pas Shkolles", h](#)
fundit

Përdhunoi gruan britanike në një rrugë të Londrës dhe më pas e kërkoi në spital, dënohet me 21 vite burg algjeriani



19 Shtator 2026, 15:15Bota TEMA



Algjeriani Salem Rekoud, 28 vjeç, është dënuar me 21 vite burg në Britani, pasi u shpall fajtor për përdhunimin e një gruaje në perëndim të Londrës. Gjykatësi e cilësoi sulmin si jashtëzakonisht serioz dhe e përshkroi Rekoud si një rrezik për publikun. Ngjarja ndodhi në korrik të vitit 2024, në zonën e Chelsea-t. Sipas të dhënave të paraqitura në Gjykatën e Kurorës në Isleworth, Rekoud e gjeti gruan gjysmë të pavetëdijshme në një stacion autobusi dhe e tërhoqi zvarrë drejt një rrugice anësore, ku e përdhunoi mes makinave të parkuara.

Sulmi zgjati rreth 17 minuta. Gjatë kësaj kohe, viktimja humbi dhe rifitoi disa herë vetëdijen, ndërsa Rekoud i kërkonte të heshte. Gruaja pësoi 33 mavijosje në pjesë të ndryshme të trupit. Pas sulmit, Rekoud telefonoi shërbimet e emergjencës, por prokuroria tha se ai u përpoq të mashtronte autoritetet duke dhënë informacione të rreme. Ai i tha një ndihmësmjeku se gruaia kishte pirë shumë alkool dhe më pas u paraqit në polici me një emër të rremë, duke u hequr si një person që po përpjeq të ndihmonte.

Por kamerat e sigurisë zbuluan se ai ndoqi ambulancën që transportoi viktimën në Spitalin Chelsea dhe Westminster. Rekoud hyri në spital dhe u pa duke lëvizur nëpër koridore e duke vëzhguar zonat e triazhit, në përpjekje për të gjetur gruan. Kur një punonjës i spitalit e pyeti se çfarë po bënte aty, ai u përgjigj: "Jam këtu për të gjetur dikë.". Rekoud u arrestua nëntë ditë pas sulmit, pasi viktimja kishte rifituar vetëdijen dhe ishte në gjendje t'u tregonte shpëtimtarëve dhe autoriteteve se çfarë kishte ndodhur.

Gruaja, identiteti i së cilës nuk është bërë publik për arsye ligjore, foli në gjykatë për pasojat e rënda fizike dhe psikologjike të sulmit. Në deklaratën e saj, ajo tha se ngjarja i kishte ndryshuar përgjithmonë jetën dhe se kishte kaluar një periudhë të rëndë psikologjike. "Ajo që ndodhi më ka shkatërruar jetën dhe unë nuk jam më i njëjti person", tha ajo, duke treguar se kishte jetuar në një gjendje të vazhdueshme frike pas sulmit. Sipas dëshmisë së saj, ajo nuk mundi të shpëtonte pasi Rekoud i kishte kërkuar të heshte dhe e kishte kapur nga qafa. Pas ngjarjes, ajo pati probleme të rënda psikologjike dhe iu desh të merrte trajtim në një njësi të shëndetit mendor.

Pas një gjyqi me juri, Rekoud u shpall fajtor për tre akuza përdhunimi dhe dy akuza për sulm seksual me penetrim dhe u dënua me 21 vite burg. 28-vjeçari kishte mbërritur në Britani në vitin 2023 me vizë turistike dhe, sipas çështjes gjyqësore, punonte si shpërndarës ushqimesh për Deliveroo, megjithëse nuk kishte të drejtë pune. Mbrotjtja e tij argumentoi se Rekoud kishte qenë më parë një futbollist premtues dhe se kishte qenë pranë përzgjedhjes në ekipin kombëtar të Algjerisë, por një dëmtim në gju i kishte dhënë fund karrierës së tij.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[AfD e hapur për takim me përfaqësuesit e Moskës](#)

14:15 Bota

Sondazhi: 48 për qind e gjermanëve presin largimin e Merz deri në fund të vitit

13:45 Bota

SHBA dhe Egjipti diskutojnë krizat rajonale, këshilltari i Trumpit telefonon Kajron: Po cenohet siguria

13:15 Bota

Përplasje në horizont? Izraeli kërkon “kompensim” nga SHBA-të

12:55 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.